



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL DURRËS

NR. Prot _____

Data _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekt i procedurës kryesore: “F.V Aparatura per banken e gjakut dhe Dixhitalizim Sherbim Imazherise” Ndare ne 2- Lote.

Loti 1 – Aparatura per banken e gjakut

Loti 2 – Pajisje per Dixhitalizimin e Imazherise

Fondi Limit Total per 2 lotet është: 1,831,666.67 Lek Pa TVSH (Nje milion e teteqind e tridhjet e njemije e gjashteqind e gjashtedhjet e gjashte pike gjashtedhjet e shtate) lekë pa tvsh

Loti 1 – Aparatura per banken e gjakut - Me Fond Limit : 775,000.00 (Shtateqind e shtatedhjete e pese mije) Lek Pa TVSH

Loti 2 – Pajisje per Dixhitalizimin e Imazherise – Me fond limit : 1,056,666.67 (Nje million e pesedhjet e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhjet e gjashte pike gjashtedhjet e shtate) Lek Pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Durres** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 9**;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 **Kopje të deklaratave të xhiros vjetore** për 3 (tre) vitet e fundit (2022, 2023, 2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se 40 % të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave, të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurren operator ekonomik.

Argumentimi: Keto kritere, janë vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një **xhiro vjetore minimale** të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në **bilancet** e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”; si dhe në pikën 1 dhe pikën 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të **xhiros vjetore** të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros

që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40% te vleres se perlllogaritur te kontrates ose lotit ne procedurat e prokurimit nen kufirin e ulet monetar.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 i ndryshuar ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' i ndryshuar ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

2.3 KAPACITETI TEKNIK DHE ARGUMENTIMI

Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregtim të pajisjeve mjekësore.

Argumentimi: Ky kriter vihet në përputhje me piken 2 te nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" lidhur me kualifikimin profesional dhe aftësinë teknike: Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

2. Të vërtetojë që ka të paktën 1 (një) Inxhinier në stafin e vet te trajnuar për pajisjet mjekësore i cili do te kryej furnizim - vendosjen e pajisjes dhe aksesorët përkatës objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet diplomës, çertifikatës/çertifikatave së trajnimit sipas aparatures qe furnizon, CV-së, kontratës individuale të punës. Inxhinjeret duhet te figurojne ne listpagesa ne 3 muajt e fundit para dates se hapjes se tenderit.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës të DST.

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet te cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtoje pajisjet mjekesore objekt prokurimi. Autorizimi duhet te jete original i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me piken 1 te nenit 77 (aftësia teknike) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe me pikën 2 të nenit 41 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

4. Ofertuesi duhet te paraqese per pajisjen mjekesore objekt prokurimi, çertifikaten CE ose deklaraten e konformitetit (sipas kategorizimit perkates) per aprovim te standarteve, direktivave ne tregun European, original i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë,

mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr.145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilesise”.

5. Ofertuesi duhet të paraqesë autodeklarate që pajisja e shoqëruar me aksesoret përkatës objekt prokurimi të jenë të reja, të papërdorura dhe prodhim i viteve të fundit (2024-2025).

***Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, në pikat 5, 6 dhe 8 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilesise”.*

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën e garancise për pajisjet, në të cilën duhet të saktesojë se periudha e garancise të jetë jo më pak se 1 (një) vit, sipas afatit të përcaktuar në specifikimet teknike. Në deklaratën për përmbushjen e afatit të garancisë (një vit garanci përfshirë blerjen edhe zëvendësimin e pjesëve të difektuara me pjesë këmbimi të reja dhe origjinaleose edhe zëvendësimin e paisjes).

***Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, në pikat 5, 6 dhe 8 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilesise”.*

7. Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

***Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se:*

[...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve e konomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata I plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e perpuethshmerise se paisjeve mjekesore që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

- 8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për pajisjen objekt prokurimi bashkë me aksesoret perkates, në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti ose Numri i references së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit.**

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me pikën 1 të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është përcaktuar se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specififikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor dhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specififikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu ky kriter është në përputhje me pikën 2 të nenit 40 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specififikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Në këtë kontekst është kërkuar dhe oferta teknike, me anë të së cilës do të bëhet e mundur verifikimi me i saktë i artikujve të ofertuar, specifikimeve të tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi.

9. Operatori do të paraqesë katalogun e pajisjes ku të jënë shënuar (markuar) specifikimet teknike.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: [...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve e konomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

- **Operatori do të kryejë furnizimin , instalimin dhe testimin e aparaturave me kostot e tij.**
- **Operatori duhet të trajtoj stafin mjekësor pas instalimit të pajisjeve mjekësore në kabinetet perkatese**

Afati i levrimit 30- Dite nga nënshkrimi i kontrates.

Te bazuar në Vendimin e KPP me Nr. 621/2024 date 04.06.2024, dhe Nr. 961/2024 date 24.07.2024 rregjistruar me tonen respektivisht me nr. 833/4 prot, date 07.06.2024 dhe Nr. 1028/5 prot, date 26.07.2024, Komisioni ve në dijeni se nuk ka kërkuar vendosjen e kriterit me përmbajtjen: “Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, kur në çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij. (të përkthyer dhe të noterizuar)”.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Loti 1 – Aparatura për banken e gjakut

Nr	Emertimi	Sherbimi	sasia (cope)
1	Centrifuge (për karta me xhel)	Banka E Gjakut	1
2	Inkubator (Mban temp 37 grade Celsius)	Banka E Gjakut	1
3	Biomixer (për perzjerjen dhe peshimin e gjakut)	Banka E Gjakut	2
4	Ngjites (sealer)	Banka E Gjakut	1

1. Centrifuge (për karta me xhel)

Centrifuga për kartat xhel është një centrifugë speciale e zhvilluar për serologjinë e grupeve të gjakut, zbulimin rutinë të grupit të gjakut, testeve të coombs, pajtueshmerive të serumit me njesine që transfuzohet, titrit të imunizimit etj.

- Fuqia hyrese 100 deri 240 VAC , 50-60 Hz, 70 VA
- Te jete me strukture çeliku dhe dhome centrifugale prej celiku inox.
- Te kete te mikroprocesor te integruar
- Programimi me butona, ekran dixhital, shfaqja ne kohë reale e të gjithë parametrave te funksionimit, funksionim i thjeshte.
- Funksioni i monitorimit të alarmit, monitorimi në kohë reale i statusit te bllokimit dhe motorit.
- Te kete mundesine e ndryshimit te shpejtësisë se centrifugimit deri ne 4000 rpm ose me shume, kohes centrifugale dhe parametrave të tjere dhe te shfage në kohe reale forcën centrifugale.
- Intervali I kohes nga 1 ne 99 sekonda
- Precisioni I xhirove 10rpm
- Te mos jete e zhurmshme : $\leq 60\text{dB}$
- Te kete certifikim CE ,ISO
- Te kete furnizim AC220V, 50/60Hz
- Te pajiset me rotor per 12 ose 24 karta me xhel

2. Inkubator (Mban temp 37 ° C)

Ky produkt do te perdoret per te kryer testet e pajtueshmerise se serumit me njesine qe do transfuzohet, testet e coombs indirect,titrat e imunizimit,identifikimit te antitropave te parregullt te ngrohje.

Projektimi i aparatit

- a. Dizajni i jashtem
 - Dizajni i integruar ge shmang shkaterrimin e veshjes prej seliku inox.
- b. Dizajni i brendshem
 - Pjesa e brendshme prej celiku inox me cilesi te larte me dizajn giysmerrethor me kater kënde per pastrim te lehte.
 - Dizajni i diafragmes kunder rëshqitjes me regullimi te hapësires, per të shmangur renien e mostres kur terhiget diafragma.
- c. Kontrolli i temperatures
 - Te jete I afte te mbaje konstante temperaturen e programuar me nje difference $\pm 0.5^{\circ}\text{C}$ (ne 37°C)
 - Ngrohje e shpejte, efekt i mire izolues ne menyre qe te mbahet temperature konstante
 - Te kete sistem mbrojtës ndaj rrymes elektrike, mbrojtësin e mbitensionit dhe alarmin e temperatures.
 - Te kete Kapacitet 30 litra
 - Temperatura te jete e programueshme nga $5\sim 85^{\circ}\text{C}$
 - Koha te jete e programueshme $0\sim 99$ minuta ose me shume
 - Te jete I pajisur me ekran LCD
- d. Te kete furnizim AC220V, 50/60Hz

3. Biomixer (per perzjerjen dhe peshimin e gjakut)

Biomixeri perdoret per te homoginizuar solucionin e qeses me gjakun ge dhurohet dhe per te matur volumin ge dhurohet

- Te jene te pajisur me ekran LED ose LCD.
- Te kete opsionin e paracaktimit te volumit te gjakut qe do dhurohet.
- Te kete Funkcion tarimi dhe kalibrimi.
- Mënrya e lekundjes te jete e bute, duke përmiresuar mbijetesën e elementeve te gjakut.
- Tundja automatike ndalon kur qesja higet gjate grumbullimit dhe rifillon punën pasi qesja vendoset pereseri.
- Nëse vëllimi i grumbullimit është i paravendosur, balanca duhet te ndalojë së lekunduri kur te kete hendek mbi 10 ml dhe do të futet ne statusin e sakte të matjes.
- Alarm automatik kur arrin vlerën e paracaktuar.
- Volumi mates 0~1200ml
- Frekuenca e lekundjes 30~32 r/min
- Shpejtesia e mbledhje 0.5~3ml/s
- Te kete furnizim AC220V, 50/60Hz
- Te kete klem per mbyllje dhe hape automatike kur fillon dhe perfundon dhurimi

4. Ngjites (sealer)

Ngjitësja e tubave të geseve të gjakut eshtë një pajisje kompakte për të ngjitur tubat geseve të gjakut pas dhurimit apo per ndarjen e nenprodukteve te gjakut ne komponente të vecantë

- Te sigurojë një ngjitje te sigurt,sterile dhe pa hemolize
- Te rregullojë automatikisht tensionin gjate ngjitjes së tubit.
- Te kete kembë me gomina për të evituar rreshqitjen
- Koha e ngjitjes : 2-4 Sekonda
- Diametric I tubit: $\Phi 2 \sim 6 \text{mm}$
- Menyra e ngjitjes:Automatike
- Të ketë furnizim AC220V, 50/60Hz

Loti 2 - Pajisje per Dixhitalizimin e Imazherise

Nr	Emertimi	Sherbimi	sasia (cope)
1	Digitalizimi (Kasete CR + PC)	Imazheri	1

Wireless kasete radiologjike digitale me standart ISO 4090 me teknologji 16 Bit per imazh te detajuar (Flat panel) dhe Kompjuter Desktop PC + Monitor

Specifikat Kasete CR:

- Teknologjia e Detektorit: Amorfi Silikon
- Scintillatori: CsI
- Sipërfaqja Aktive (inç): 14×17
- Matriks Pikselësh: 2304×2800
- Distanca e Pikselëve (μm): 150
- Rezolucioni Hapësinor (lp/mm): 3.4
- Autonomia e Baterisë (orë): 8

- WiFi 2.4G dhe 5G, IEEE802.11 a/b/g/n/ac
- Modaliteti i Aktivizimit: Automatic Exposure Detection/(Opsionale) Software
- Ruajtja e Brendshme e Imazheve: 200 imazhe me madhësi të plotë
- Koha për Imazh të Plotë (s) 5
- Përmasat (mm³): 384 × 460 × 15
- Pesha (kg): 3.3 ±5%
- Te duroj Ngarkesa Statike 150 kg Uniforme
- Mbrojtja ndaj Depërtimit IPX1
- Temperatura e Funksionimit (°C) 5 ~ 35
- Te jet I paisur me dy bateri + karikues
- Software:
- Mundësin e zgjedhjes së zonës që do të kryet egzaminimi
- Te paraqesi në grafike 3D mënyrën e pozicionimit të pacientit
- Te ketë mundësinë e shkruarjes së raportit dhe dërgimin e tij në PACS
- Te ofroj mundësinë e Image Sticking
- Te ketë opsionin e grides virtuale

Specifikat për kompjuter Desktop + monitor (minimumi i specifikave)

- CPU Benchmark minimal: 8500 pikë
- RAM: 8 GB DDR4
- SSD: 500 GB
- Grafikë: Integruar, ≥1GB
- Porta: ≥6 USB, 1 RJ-45, DP/DVI/HDMI/VGA
- OS: Windows 11 Pro 64-bit (OEM)
- Monitor: ≥21", 1920x1080, ≤6ms, kontrast 1000:1

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Argumentimi për specifikimet teknike janë vendosur në bazë të materialit të përgatitjes së specifikimeve teknike dhe përlogaritjes së fondit limit me nr. 466/6 prot., dt. 04.09.2025 të përgatitur nga grupi i punës i ngritur me urdherin e brendshëm me nr. 466/1 prot., dt. 27.03.2025, si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe neneve 20 dhe 49 të Ligjit nr. 105/2014 “Për Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik”.

U ngarkua në sistemin e prokurimit elektronik nga njësia e prokurimit